



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

EKSTRAKT

nga procesverballi i mbajtur më 19 tetor 2015, në mbledhjen e XXI-të
(njëzetënjë) të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 13.05’.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z. Mehmet Gashi, kryesues i Kuvendit, përkatësisht kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e këtij Komiteti, përkatësisht Bahri Blakçori, Islam Revuçi, Fidan Rekaliu, Haki Rudari, Kadri Avdiu, Kumrie Hoti, Mynavere Abdullahau – Krasniqi, Naim Çunaku dhe Rafet Llapashtica, ndërkaq mungoi z. Afrim Shabani.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Avni Maloku, drejtor i Drejtorisë së Arsimit, Avni Fetahu, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Faik Muçiqi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit dhe Muharrem Haziri, OSBE.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i propozuar i ditës u miratua njëzëri.

2. Propozimi i vendimit për ri-alokim të Buxhetit të Komunës për vitin 2015

z. Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, e paraqiti fjalën e hyrjes.

z. Fidan Rekaliu, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve të LDK – së e mbështesim propozimin e këtij Vendimi ngase jemi të bindur se ri-alokimi i propozuar i mjeteve buxhetore bëhet në përputhje të plotë me dispozitat ligjore të cilat e rregullojnë çështjen e financave publike.

Përndryshe drejtori i Drejtorisë përkatëse, në fjalën hyrëse, e sqaroi në mënyrë të qartë nevojën për ri-alokimin e mjeteve të caktuara.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, me qëllim që të mos përsëriten diskutimet por edhe të kursej kohën, për këtë çështje do të diskutoj në mbledhjen e nesërme të Kuvendit.

z. Faik Muçiqi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, theksoi, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Agjencioni i Menaxhimit të Emergjencave kanë premtuar se do ta ndërtojnë objektin komplet të Shërbimit të Zjarrfikësve, andaj kjo është arsyeja që bëhet ri-alokimi i mjeteve të projektit – ndërtimi i garazhës dhe rregullimi i oborrit të SHZSH-së.

Te kanalizimi fekale në fshatin Dyz e kemi proceduar fazën e parë ngase nuk kemi pasë mundësi ta realizojmë projektin gjithëpërfshirës për tërë fshatin, mirëpo ky projekt do të vazhdojë vitin e ardhshëm.

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, theksoi, ri-alokimi është i domosdoshëm për të plotësuar mjetet në realizimin e projekteve në të cilat ka mungesë të mjeteve financiare dhe atë që ato mjete të merren prej projekteve ku ka tepriçë të mjeteve.
Pas votimit u konstatua se Kuvendit njëzëri i rekomandohen për shqyrtim.

3. Informatë e Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

z. Rafet Llapashtica, theksoi, në mbledhjen e kaluar z. Haki Rudari ka kërkuar që të përgatitet kjo informatë në mënyrë që ky Komitet dhe Kuvendi të informohen në veçanti për dhënien e subvencioneve, mirëpo në informatën e paraqitur janë të dhënat se sa hektar janë korrë, sa subvencione të bletëve janë ndarë dhe të dhëna të tjera të parëndësishme.

Jam i mendimit se kësaj informate do duhej t'i bashkëngjitet edhe Vendimi i Komisionit prej tre anëtarëve i cili e ka bërë përzgjedhjen e përfituesve të subvencioneve, këtë e kërkoj ngase në mjete të informimit është thënë se ai komision nuk e ka kryer punën me korrektësi meqë bletët të njëjtës familje i janë ndarë nga dy herë.

Konsideroj se kjo informatë nuk është përgatitur mirë në aspektin profesional edhe se jam i bindur se drejtori i Drejtorisë përkatëse ka aftësi ta prezantojë një informatë më të mirë, por nuk jam në dijeni për arsyet përse informata eshë paraqitur si e tillë.

z. Haki Rudari, theksoi, edhe më herët kam kërkuar informatë nga Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, mirëpo edhe pse me vonesë është mirë që është paraqitur, konsideroj se në të ardhmen, jo vetëm kjo Drejtori por edhe Drejtoritë tjera do duhej të paraqesin informata të këtilla në perioda të rregullta kohore.

Këtë informatë në parim e mbështes dhe ne Grupi i këshilltarëve të LVV – së në vazhdimësi e kemi përkrahur subvencionimin e bujqësisë, madje në mbledhjen e fundit kur është shqyrtuar projektbuxheti unë kam propozuar që për vitin e ardhshëm të rritet buxheti për Drejtorinë e Bujqësisë.

Konsideroj se te ndarja e subvencioneve është dashtë të merren parasysht emergjencat dhe rastet që vërtetë kanë nevojë, pra në këtë drejtim ka vërejtje nga ana e bujqve.

E kam përmendur edhe në Kuvend edhe në këtë Komitet se do të ishte mirë të ngritët një komision në përbërje të përfaqësuesve të subjekteve politike ngase sipas mendimit tim ky komision do ta ndihmonte Drejtorinë e Bujqësisë, Pylltarisë

dhe Zhvillimit Rural, mirëpo kjo çështje nuk është marrë në konsideratë edhe pse sipas informacioneve që i kam në disa komuna është ngritë komisioni i cekur.
Pas votimit u konstatua se kjo informatë njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim.

Mbledhja përfundoi në orën 13.35'

**Procesverbalin e mbajti
Faik Gashi**

**Nr. 01- 006-92634
Podujevë,
19 tetor 2015**

**Kryesuesi i Komitetit
Mehmet Gashi**